REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primljeno: 01.07.2021

Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
15-353-	35734	

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12,14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040,Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 5 par.1.2 nenit 10, nenit 26 paragrafi 7 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, nenit 9,17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.06.2021, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E SHTËPISË TË KOMUNITETIT NË VENDBANIMIN GADIME TË ULËT

Neni 1

Me këtë Vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e shtëpisë së komunitetit në vendbanimin Gadime të Ulët.

Neni 2

Lokacioni sipas këtij vendimi ka këto karakteristika: pjesë e njësisë kadastrale P-71409028-01049-16 me sipërfaqe prej 500m² (5 ari) sipas Certifikatës-Njësisë kadastrale Nr.2665/2021 me kulturë kullosë, klasa 6-të me sipërfaqe të përgjithshme prej 383841m² Zona kadastrale Gadime të Ulët, në pronësi Komuna e Lipjanit, sipas PZHK zonë e definuar si vendbanim joformal.

Neni 3

Qëllimi i caktimit të lokacionit sipas këtij Vendimi është: ndërtimi i shtëpisë së komunitetit e cila ka për synim gjithëpërfshirjen sociale për grupet e margjinalizuara, me fokus të veqantë komunitetet Rom,Ashkali dhe Egjiptian.

Neni 4

Procedura e implementimit që rezulton me zhvillimet tjera që ndërlidhen me planifikimin, ndërtimin dhe menaxhimin do të jenë pjesë e zhvillimeve në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal dhe Harten Zonale të Komunës.

Neni 5

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi të bënë parcelimin e sipërfaqës në përputhje me kushtet e percaktuara në HZK ta evidenton në librat kadastral në pronësi të komunës së Lipjanit.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 15-353-35734
Lipjan, më 30.06. 2021

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi